

RENDI I DITËS


Shorti “Për caktimin e relatorëve të kërkesës ankimore nr. 14, 15, 16”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Znj. M. Çelmeta, z. E. Mema.**

Znj. M. Çelmeta: Përshendetje! Sot më datë 05 Nëntor 2024 do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit për 3 kërkesa ankimore. Kërkesa ankimore nr. 14, me ankues me ankues TV Kopliku dhe kërkesa ankimore nr. 15, me ankues Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtesi Europiane kanë si objekt kundërshtimin e vendimit nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kërkesa ankimore nr. 16, me ankues z. Vangjel Tavo ka si objekt kundërshtimin e vendimit nr. 187, datë 08.10.2024 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Procedura e hedhjes së shortit është e parashikuar në nenin 14, të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në tre prej tyre janë shënuar kërkesat ankimore dhe shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat do të futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente. Viojmë me futjen e shiritave në gogla. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 05.11.2024*

autorizuar një përfaqësues nga KQZ të tërheqë goglat në emër dhe për llogari të tyre për caktimin e relatorit. Viojmë me përzierjen.

Hapim goglën e parë shiriti është i bardhë dhe pa shënim.

Hapim goglën e dytë shiriti është përsëri i bardhë dhe pa shënim.

Hapim goglën e tretë dhe shiriti është me shënim “kërkesa ankimore nr. 16, ankues zotin Vangjel Tavo”.

Hapim goglën tjetër dhe shiriti është me shënim “kërkesa ankimore nr. 15”.

Hapim goglën e fundit dhe kjo është me shënimin “kërkesa ankimore nr. 14”.

Në përfundim të procedurës së shortit:

Relator për kërkesën ankimore nr. 14 është zoti Ledio Braho.

Relator për kërkesën ankimore nr. 15 është zoti Koli Bele.

Relator për kërkesën ankimore nr. 16 është Ilirjan Rusmali.

Përfunduar me shortin, ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

